



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2571, datë 22.05.2015

Për

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit””

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.05.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit””.

BAZA LIGJORE:

1. Kodi i Procedurës Administrative (**KprA**);
2. Neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”**”);
3. Rregullore nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010, e ndryshuar, (**Rregullore nr. 13**);

4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit””;
- Dokumenti për Këshillim Publik;
- Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP i formatuar dhe arsytuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Drejtoria e Administrimit të Frekuencave, Numeracionit dhe Autorizimeve dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Aplikacioneve me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet normative rregullore dhe në kuadër të mbykqyrjes së ofruesit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Drejtues dokumentin për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”;
2. Dokumenti për Këshillim Publik është hartuar për të evidentuar nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe të interesuar të tjerë për ofrimin e shërbimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar, nëse funksionimi duhet ndryshuar ose shtuar ndonjë funksionalitet dhe nëse persona të tjerë juridikë janë të interesuar të ofrojnë bazën e të dhënave referencë;
3. Marrjen në konsideratë të:
 - çështjeve të konstatuara që nga fillimit i portabilitetit të numrit, në vitin 2011 e deri në takimin e fundit me operatorët e telefonisë fikse dhe të lëvizshme;
 - numrin e operatorëve të ofrimit të shërbimit të portabilitetit që janë të lidhur me CRBD;
 - kërkesat e operatorëve që kërkojnë të lidhin sistemet e tyre në mënyrë automatike me CRBD.
4. Nga pikepamja thelbësore propozimi është përgatitur bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, në nenin 110 të ligjit 9918, i ndryshuar, dhe nenit 10 të Rregullores nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, të ndryshuar.
5. Dokumenti për këshillim publik i shërben qëllimit të përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që dalin kjo rregullore dhe vendimet e AKEP-it në funksion të ofrimit të shërbimit të CRDB të portabilitetit të numrit, përmirësimit, në zgjerimin e mënyrës së operimit të CRDB etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, dhe ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, te ndryshuar, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti,

V E N D O S:

1. Të miratojë për këshillim publik dokumentin “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Periudha e këshillimit publik do të jetë 45 ditë nga data e publikimit të dokumentit në internet në faqen zyrtare të AKEP;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____

DOKUMENTI PËR KËSHILLIM PUBLIK

Për

“Performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për Portabilitetin e Numrit”

1. AKEP bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar Rregulloren nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, kryen kete keshillim publik me palet e interesuara në lidhje me funksionimin e CRDB, me qëllim marrjen e të gjitha opinioneve të mundshme nga palët e interesuara.

Bashkëngjitur janë raportet e gjeneruara nga sistemi.

AKEP kerkon vleresimin dhe argumentat tuaja lidhur me këtë çështje?

2. *Pyetje: A keni koment lidhur me funksionimin dhe teknologjinë e përdorur? Në se mendoni se funksionimi duhet ndryshuar ose zgjeruar ju lutemi argumentat tuaj.*
3. AKEP, kerkon vleresimin tuaj mbi nivelin e bashkëpunimit midis AKEP, ofruesit të CRDB dhe operatorëve që përdorin këtë sistem. *Argumentat tuaja lidhur me këtë çështje duke i bashkëngjitur dhe rastet kur keni komunikuar me AKEP apo me ofruesin e CRDB ?*
4. AKEP, kerkon vleresimin tuaj ne se shërbimi që ofrohet nga CRDB është gjithë përfshirës. *Argumentat tuaja lidhur me këtë çështje dhe nëse keni propozime të tjera?*
5. AKEP bazuar në Rregulloren nr.13 “Për Portabilitetin e Numrit” e ndryshuar, kërkon të evidentojë nëse ka persona të tjerë juridik, të interesuar për të qënë ofrues të bazës se te dhenave reference të centralizuar.
6. Argumentat nëse keni ndonjë çështje tjetër për t’u marrë në konsideratë.

Shpjegues për këshillimin publik

Ky këshillim realizohet për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit.

Portabiliteti i numrit është me rëndësi për të gjithë operatorët të cilët përdorin numra gjeografikë dhe/ose numra të lëvizshëm në rrjetet e tyre.

AKEP, ka për qëllim të realizojë zgjidhje që:

- do të kontribuojnë ndaj konkurrencës, në veçanti duke e bërë të lehtë dhe të shpejtë për bartjen e një numri nga një rrjet tek tjetri;
- sjellin përfitime më të mëdha për abonentët dhe operatorët dhe që mbrojnë interesat e abonentëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, në vecanti në lidhje me transparencën e tarifave;
- janë neutrale nga pikëpamja e teknologjisë;
- janë plotësisht në përputhje me legjislacionin aktual të BE-se.

AKEP-i fton të gjithë operatorët ti përgjigjen këtij Këshillimi Publik.